



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-Ministarstvo Industrije,
Preduzetništva i Trgovine-Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

DRAFT KONCEPT DOKUMENTI PËR FUSHËN E METROOGJISË

Përgatitur nga *Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë*

Prill, 2024

Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit..... **Error! Bookmark not defined.**

Hyrje **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit..... **Error! Bookmark not defined.**

Analiza e Transpozimit të Acquis së BE-së

Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

Kapitulli 2: Objektivat **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 3: Opsionet..... **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim..... **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit..... **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 3.3: Opsioni për hartimin e Projektligjit të ri për Metrologji

Error! Bookmark not defined.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi..... **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm..... **Error! Bookmark not defined.**

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin **Error! Bookmark not defined.**

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik..... **Error! Bookmark not defined.**

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore **Error! Bookmark not defined.**

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore **Error! Bookmark not defined.**

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore . **Error! Bookmark not defined.**

Përmbledhje e koncept dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti në fushën e metrologjisë
Ministria bartëse	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Personi kontaktues	Sebahate Bushrani-Ibrahimi, Zv. e Drejtorit të Përgjithshëm të AMK-së
PKZH	Pjesë e PKZH 2024 - 2026. Qëllimi strategjik: - Ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve dhe ulja e varësisë së tepërt në importe Masa strategjike: - Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht Aktiviteti: Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për fushën e metrologjisë
Prioriteti strategjik	Ndërlidhja me disa prioritete strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. 1. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 Shtylla1: Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik Qëllimi 1: Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese Objektivi Strategjik: Zhvillimi i industrisë drejt produkteve dhe shërbimeve me vlerë më të lartë të shtuar. 2. Plani Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028 Blloku III: Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis-në e BE-së 3.1. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave 3.1.6. Koncept Dokumentit për fushën e Metrologjise, i miratuar 3. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 2.8. Industria, ndërmarrësia dhe tregtia; 2.8.6 Përmirësimi i infrastrukturës së cilësisë, përfshirë mbrojtja e konsumatorit; 4. Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030 5.1.1. Objektivi 1: Zgjerimi (shtrirja) e Prodhimit Industrial 5.2.2. Nën-objektivat sipas Objektivit 1: 5.2.2.4. Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht.

Vendimi	
Çështja kryesore	Nevoja për avancimin e metrologjisë në përputhje me zhvillimet e tregut dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare të Metrologjisë
Përmbledhje e konsultimeve	Do të plotësohet pas konsultimeve

Opsioni i propozuar	Ligji i ri për Metrologji
---------------------	---------------------------

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Ka kosto shtesë.
Ndikimet ekonomike	Në mbrojtjen e konsumatorit, bizneseve dhe konkurrencën.
Ndikimet shoqërore	Në rritjen e besueshmërisë, parandalimin e krimit dhe sigurinë në përgjithësi.
Ndikimet mjedisore	Në mbrojtjen e mjedisit.
Ndikimet ndër-sektoriale	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Ka ndikime relevante.
Testi i NVM-ve	Nuk është aplikuar Testi i NVM-ve.

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Hartimi i Ligjit për Metrologjinë
Afatmesëm	Zbatimi i Ligjit, ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve.

Hyrje

Ligji për Metrologjinë¹ rregullon sistemin e njësive matëse, etalonët për matje, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e para paketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbrojtjen e konsumatorëve dhe sigurinë e përgjithshme nga rezultatet e pasakta të matjeve.

Ky Ligj përcakton organizimin e kontrollit të instrumenteve matës në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare, mbrojtjen e shëndetit, mjedisit dhe sigurisë teknike, kontrollin sasior të para paketimeve si dhe ofrimin e shërbimeve të kalibrimit prodhuesve dhe përdoruesve të mjeteve matëse, për të qenë konkurrues në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me parimet dhe kriteret kryesore të Direktivës së BE-së 2014/32 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 26 shkurt 2014 për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare përkritazi me vënien në dispozicion të tregut të mjeteve matëse si dhe dokumentin Zhvillimi i kuadrit institucional dhe legjislativ -D1:2020 të OIML-së.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen në organizimin e aktiviteteve metrologjike, përdorimin e njësive matëse ligjore dhe gjurmueshmërinë e etalonëve të matjes në Republikën e Kosovës, vendosjes në treg dhe përdorimin e mjeteve matëse ligjore, vlerësimin e konformitetit të mjeteve matëse ligjore me kërkesat e përshkruara, produkteve të para-paketuara dhe shishet si enë matëse, vlefshmërinë e dokumenteve dhe shenjave të huaja të konformitetit, mbikëqyrjen metrologjike, si dhe çështje të tjera të lidhura me metrologjinë.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në këtë rast Agjencia Metrologjisë së Kosovës është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kornizës ligjore për fushën e metrologjisë. Bazuar në pritoritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Planin Kombëtar për Zhvillim, është vendosur qëllimi për ti adresuar problemet praktike të shfaqura gjatë zbatimit të Ligjit e të identifikuar nga Agjencia dhe palët me interes. Si rrjedhojë, me Sekretari i Përgjithshëm i Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka formuar grupin punues për hartimin e draftit fillestar të Koncept Dokumentit në Fushën e Metrologjisë². Ky koncept është përfshirë edhe në listën e Koncept Dokumenteve për vitin 2024. Qëllimi i këtij Koncept Dokumenti është që të analizoj problemet aktuale në fushën e metrologjisë dhe propozoj opsionin më adekuat për të adresuar ato, probleme që krijojnë vështirësi në funksionimin e lirë të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit, shëndetit publik dhe mjedisit.

Andaj, bazuar në udhëzuesin dhe doracakun për hartimin e koncept dokumenteve është hartuar ky Koncept Dokument i cili do të propozoj opsionin e rekomanduar nga grupi punues.

¹ Ligji nr. 06/L-037 për Metrologjinë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 7/2018.

² Vendimi i datës 11 Janar 2024, me numër të protokollit 138/02.

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti ne fushën e metrologjisë
Ministria bartëse	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë– AMK
Personi kontaktues	Sebahate Bushrani-Ibrahimi , Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të AMK Sebahate.bushrani@rks-gov.net
PKZH	Pjesë e PKZH 2024 - 2026. Qëllimi strategjik: - Ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve dhe ulja e varësisë së tepërt në importe Masa strategjike: - Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht Aktiviteti: Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për fushën e metrologjisë
Prioriteti strategjik	Ndërlidhja me disa prioritete strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. 1. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 Shtylla1: Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik Qëllimi 1: Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese Objektivi Strategjik: Zhvillimi i industrisë drejt produkteve dhe shërbimeve me vlerë më të lartë të shtuar. 2. Plani Kombëtarë për Integrim Evropian 2024-2028 Blloku III: Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis-në e BE-së 3.1. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave 3.1.6. Koncept Dokumentit për fushën e Metrologjisë, i miratuar 3. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 2.8. Industria, ndërmarrësia dhe tregtia; 2.8.6 Përmirësimi i infrastrukturës së cilësisë, përfshirë mbrojtja e konsumatorit; 4. Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030 5.1.1. Objektivi 1: Zgjerimi (shtrirja) e Prodhimit Industrial 5.2.2. Nën-objektivat sipas Objektivit 1: 5.2.2.4. Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht.
Grupi punues	- Sebahate Bushrani -Ibrahimi -(MINT -AMK) zv. Drejtore e përgjithshme e AMK-së – Kryesuese; - Avdullah Jasiqi-(MINT -AMK) Udhëheqës i laboratorit të Forcës dhe Presionit - anëtar;

	• Samir Zefaj -(MINT -AMK), Specialiste ne sektorin e para paketimeve - anëtare; • Remzije Hajdari –(MINT) Udhëheqëse e Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit, Departamenti Ligjor (MTI) – anëtare; • Besarta Binaku- (MINT) Analiste e lartë e buxhetit për buxhet dhe financa - anëtare; • Lebib Haliti-(MTI) zv. Drejtore e ARB-së – anëtare; • Fexhrie Salihu -(MINT) Inspektore e tregut -Sektori për cilësi dhe tregti të derivateve të naftës -anëtar; • Qefsere Ajeti (MINT)- Agjencia e standardizimit të Kosovës- anëtare • Shkurte Krasniqi -(SQK) Koordinatorë për politika ekonomike– anëtare; • Dardan Nallbani (MINT)- Zyrtar i lartë për Integritet Evropian • Liridona Hoti – ZKM – anëtare;
Informata shtesë	Nuk ka informata shtesë

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (AMK) është agjenci ekzekutive në kuadër të MINT që është ekskluzivisht përgjegjëse për fushën e metrologjisë në Republikën e Kosovës. Agjencia funksionon e ndarë në Departamentet dhe divizionet në vijim:

- Departamenti për Metrologji Shkencore dhe Industriale;
- Departamenti për Metrologji Ligjore;
- Divizioni për Mbikëqyrje Metrologjike, dhe
- Divizioni për Metale të çmuara.

Bazuar në Raportin e vitit 2023, Agjencia e Metrologjisë së Kosovës ka qenë e angazhuar në aktivitetet në vijim:

• Vendosja e gjurmueshmërisë në laboratorët e AMK-së:

Për të gjitha laboratorët testues/kalibruar dhe verifikues, zinxhiri i gjurmueshmërisë është përcjellë nga etalonët ndërkombëtarë te etalonët shtetërorë, gjithashtu nga etalonët primarë gjurmueshmëria është përcjellë te etalonët sekondarë.

Gjurmueshmëria e etalonëve shtetëror, në pajtim me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI), është përcjellur, nga Institutet nacionale ndërkombëtare të Metrologjisë

Bartja e zinxhirit të gjurmueshmërisë (kalibrimi i etalonëve të punës) për të gjithë etalonët, të cilët përdoren në aktivitetet e metrologjisë ligjore, janë realizuar nga etalonët shtetëror deri tek etalonët e punës të fushave përkatëse të metrologjisë.

- Në metrologjinë Ligjore kryhen këto shërbime:
 - Verifikimi i fillestar i instrumenteve matëse
 - Verifikimi periodik i instrumenteve matëse
 - Verifikimi i jashtzakonshëm i instrumenteve matëse
 - Verifikimi i sasisë së parapaketimeve dhe shisheve si enë matëse

- Në metrologjinë shkencore dhe industriale kryen këto shërbime:
 - *Kalibrimin e instrumenteve matëse sipas kërkesave*
- Inspektime dhe mbikëqyrje metrologjike
- Shërbimet metrologjike të realizuara nga subjektet e emëruara nga AMK-ë:
 - *Verifikimi i tahografëve*
 - *Verifikimi i taksimetrave*
 - *Verifikimi i pajisjeve matëse në Qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve*
- Zhvillimi, Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) në laboratorët e AMK-së:
- Rivlerësimi i parë vjetor, i laboratorëve kalibrues të akredituar, sipas standardit EN ISO/IEC 17025: 2017
- Pjesëmarrja në ndër-krahasime laboratorike bilaterale dhe multilaterale në nivel ndërkombëtar:
- Ngritja e kapaciteteve profesionale e stafit
- Pjesëmarrja në konferenca dhe takime ndërkombëtare në fushën e metrologjisë,
- Pjesëmarrja në komitetet teknike të EURAMET-it dhe WELMEC-ut

Mungesa e kapaciteteve administrative në institucionet e infrastrukturës së cilësisë, përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve administrative në fushën e hartimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe standardeve teknike për lëvizjen e lirë të mallrave është evident dhe vazhdon të jete sfide për AMK-në.

Problemet aktuale në këtë fushë janë si rezultat i shkaqeve të identifikuar si në vijim:

- Mungesa e dispozitave ligjore për:
 - Trupat e emëruar për vlerësim të konformitetit
 - Ftesa publike nuk është e përcaktuar
 - Nuk është e përcaktuar forma e masave për operatorët ekonomik të cilët ofrojnë shërbime metrologjike pa emërim nga MINT- sidomos në raste kur kryejnë aktivitete metrologjike, para emërimit si TVK.
 - Mungesa e dispozitave ligjore që e rregullon mundësinë që njëkohësisht me TVK-të në fusha përkatës të ekzistoj mundësia që AMK të kryej aktivitetet në fushat e njëjta.
 - Autorizimin e operatorëve ekonomik për riparimin dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim
 - Ftesa publike nuk është e përcaktuar
 - Krijimi i komisionit po ashtu nuk është i përcaktuar
 - Nuk është e përcaktuar forma e masave për operatorët ekonomik të cilët operojnë pa leje nga AMK - sidomos në raste kur kryejnë aktivitete para emërimit si trup e autorizuar
 - Përzierje e kompetencave në mes të menaxhmentit dhe specialistëve të laboratorëve për:

- Frekuencën e kalibrimit të Etalonëve të matjeve dhe materialeve referente në laboratorët e metrologjisë ligjore.
- Nevoja për harmonizim me ligjin për IQMT (Inspektorati Qendror për Mbikëqyrjen e Tregut)
- Nevoja e rishikimit të dispozitave për kundërvajtje.
- Një numër i akteve nënligjore në fuqi janë të bazuar në ligjin e vjetër të vitit 2010.
- Nevoja për thjeshtësim të procedurave për emërim të trupave dhe dhënie e autorizimeve për operator ekonomik.
- Digjitalizimi i sistemit të AMK-së.

Në përkufizimin e problemit janë konsultuar inputet nga: konsultimet publike me palët e interesit, ligjet, aktet nënligjore.

Figura 2 – Lista e akteve më të rëndësishme të *acquis* nga fusha e Metrologjisë dhe niveli i transpozimit

Nr.	Dispozitat e Traktatit / Rregulloret / Direktivat / Legjislacioni dytësor	Përmbajtja dhe qëllimi	Legjislacioni vendor që transponon <i>acquis</i> të BE-së dhe niveli i përputhshmërisë
1	Direktiva 2014/32EU	Direktiva përcakton rregulla uniforme, në mbarë BE-në për shitjen dhe vënien në përdorim të instrumenteve matëse.	Ligji nr. 06/l -037 për metrologji <i>Pjesërisht e transpozuar.</i>
2	Direktiva 2014/31EU	Direktiva përcakton rregulla uniforme, në mbarë BE-në për shitjen dhe vënien në shërbim të instrumenteve të peshimit joautomatik (NAWIs).	Rregullorja për peshoret jo automatike MTI nr.04/2018. <i>Pjesërisht e transpozuar.</i>
3	Direktiva 2007/45EC	Direktiva parashtrohet rregullat e sasive nominale për produktet e para-paketuara. Direktiva 2007/45EC plotëson ndryshon direktivën 76/211/EEC.	Rregullorja për parapaketime (MEPTINIS) Nr. 03/2020. <i>Pjesërisht e transpozuar.</i>

4	Direktiva 76/211/EEC	Direktiva në lidhje me përgatitjen sipas masës ose vëllimit të disa produkteve të parapaketuara.	Rregullorja për parapaketimet (MEPTINIS) Nr. 03/2020. <i>Pjesërisht e transpozuar.</i>
5	Vendimi Nr. 768/2008 EC	Vendimi për Kornizën e Përbashkët për Marketingun e Produkteve	Udhëzimi administrativ Nr. 04/2016 për mënyrën e autorizimit të trupave për vlerësim të konformitetit. <i>Pjesërisht i transpozuar.</i>
6	Direktiva 75/107EEC	Direktiva mbi shishet të cilat përdoren si enë matëse.	Udhëzimi administrativ (MTI) Nr. 04/2020 për shishet si enë matëse. <i>Pjesërisht e transpozuar.</i>
7	Direktiva 80/181EEC	Direktiva mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me njësitë e matjes;	Udhëzimi administrativ Nr. 11/2013 për përdorimin e njësive matëse. <i>Pjesërisht e transpozuar.</i>
8	Direktiva 2009/3EC	Direktiva plotëson-ndryshon Direktivën 80/181/EEC mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me njësitë e matjes.	Udhëzimi administrativ Nr. 11/2013 për përdorimin e njësive matëse. <i>Pjesërisht e transpozuar.</i>
9	Direktiva 2014/32EU	Kjo direktive përcakton rregulla uniforme, në mbarë BE-në për shitjen dhe vënien në përdorim të instrumenteve matëse.	Rregullore (MTI) Nr. 06/2016 për mjetet matëse. <i>Pjesërisht e transpozuar.</i>

1.4 Dokumentet relevante

Në vijim janë paraqitur dokumentet relevante të politikave, ligjeve dhe akteve nënligjore që ndërlidhen me fushën e Metrologjisë:

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji Nr. 06/L-037 për Metrologji	Ligji	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	Zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga AMK
Ligji Nr. 06/L-019 për standardizim	Ligji	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	Kërkesat e përgjithshme për standarde ndërkombëtare EN ISO
Ligji Nr. 05/L-117 për Akreditim	Ligji	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	Kriteret e përgjithshme për kompetencën e laboratorëve të kalibrimit dhe testimit (EN ISO/IEC 17025:2017) dhe Laboratorët verifikues SK ISO/IEC 17020
Projektligji për Inspektoratin Qendror të mbikëqyrjes së tregut	Projektligji	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	Zbatimi dhe implementimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga AMK
Ligji Nr. 08/L-029 për Punimet nga Metalet e Çmuara	Ligji	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	Zbatimi dhe implementimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga AMK
Ligji Nr. 04/L190 për produkte dhe pajisje medicinale	Ligji	Ministria e Shëndetësisë	Metrologjia e pajisjeve medicinale
Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 12/2018 për Mënyrën e emërimit të trupave për	Ligji	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	Kriteret e përgjithshme për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit

vlerësim të konformitetit			
Rregulloret që derivojnë nga LIGJI Nr. 06/L -037 PËR METROLOGJI	Gazeta zyrtare https:// rks-gov.net/	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë- Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	Zbatimi dhe implementimi i akteve nënligjore nga AMK; MINT është sponsorizues i kornizës ligjore.
Aktet nënligjore që derivojnë nga LIGJI Nr. 06/L -037 PËR METROLOGJI	Gazeta zyrtare https:// rks-gov.net/	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë- Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	Zbatimi dhe implementimi i akteve nënligjore nga AMK; MINT është sponsorizues i kornizës ligjore.

1.5 Problemi kryesor

Në këtë nën-kapitull është paraqitur pema e problemit që përmban problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e tij. Të njëjtat gjithashtu janë analizuar në pjesën narrative si më poshtë.

Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	1. Dëmtimi i operatorëve ekonomik dhe konkurrencës
	2. Dëmtimi i konsumatorit
	3. Mundë të sjellë ndërprerjen e punës së laboratorit
	4. Mos-harmonizimi në mes të Ligjit për Metrologji me Projektligjin e Inspektoratit Qendror të Tregut dhe Ligjin në fuqi për Kundërvajtje që mund të krijoj vështirësi në zbatim
Problemi kryesor	Nevoja për avancimin e metrologjisë në përputhje me zhvillimet e tregut dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare të Metrologjisë
Shkaqet	Mungesë e dispozitave ligjore:
	1. Për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit dhe autorizimin e trupave për shërbime metrologjike nuk ka dispozitë ligjore që e rregullon kohën e shpalljes së ftesës publike
	2. Nuk ka dispozitë ligjore që e rregullon krijimin e komisionit vlerësues për trupat e autorizuar për shërbime metrologjike
	3. Nuk janë të përcaktuar masat ndëshkimore ndaj operatorëve ekonomik të cilët ofrojnë shërbime metrologjike pa qenë të emëruar dhe autorizuar nga MINT-AMK duke i përfshirë edhe operatorët që janë në proces të emërimit apo autorizimit

	4. Mungon dispozita ligjore e cila përcakton dhe ndanë përgjegjësit e trupave të emëruar për vlerësim të konformitetit dhe laboratorit përkatës të metrologjisë ligjore (AMK) lidhur me aktivitetin e njëjtë.
	5. Nuk ka dispozitë ligjore që obligon verifikimin e saktësisë së instrumenteve matëse medicinale
	6. Përgjegjësitë për afatin e kalibrimin të etalonëve të matjeve dhe materialet referente në metrologjinë ligjore duhet të rregullohet me qëllim të eliminimit të parregullsive dhe përzierjes së kompetencave.
	7. Harmonizimi i detyrave dhe përgjegjësi të Inspektimeve, mbikëqyrjes dhe çështjeve të kundërvajtjes
	8. Harmonizimi i ligjit për metrologji me Projektligjin e inspektoratit dhe ligjit për kundërvajtje.
	9. Nevoja për digjitalizimin e shërbimeve të AMK-së
	10. Nevoja për përafrimin e mëtejme me <i>acquis</i> të BE-së dhe praktikat e mira ndërkombëtare

Shkaqet

1. Për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit nuk ka dispozitë ligjore që e rregullon kohën e shpalljes së ftesës publike. Kjo po krijon një problem për subjektet ekonomike të interesuara dhe njëkohësisht krijon hapësira të mosfunksionimit normal dhe përcaktimit të qartë të kriterëve bazë për emërim

Analiza 1: Në Nenin 35 të Ligjit nr. 06/L -037 për Metrologji që është në fuqi, rregullon çështjen e emërimit të trupave për vlerësim të konformitetit por nuk ka një dispozitë ligjore që e përcakton formën e kërkesës për aplikim. Çdo aplikim për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit duhet të pasoj me shpallje publike nga AMK. AMK bën shpallje publike sipas nevojave por jo më shumë se 2 herë në vit.

2. Nuk janë sqaruar masat ndëshkimore për operatorët ekonomik të cilët ofrojnë shërbime metrologjike pa u emëruar nga MINT duke i përfshirë edhe ata operator që janë në proces të emërimit

Analiza 2: Në Neni 35 të Ligjit nr. 06/L-037 për Metrologji që është në fuqi, rregullon çështjen e emërimit të trupave për vlerësim të konformitetit, por nuk e ka asnjë dispozitë ligjore që e rregullon masat ndëshkimore për operatorët ekonomik të cilët ofrojnë shërbime metrologjike pa emërim nga MINT.

3. Nuk ka dispozitë ligjore që e rregullon se, pas emërimit të trupave për vlerësim të konformitetit në metrologjinë ligjore, për aktivitete të njëjta që kryen AMK se a ndalohet apo nuk ndalohet aktiviteti i AMK-së

Analiza 3: Në Nenin 35 të Ligjit nr. 06/L -037 për Metrologji që është në fuqi, rregullon çështjen e emërimit të trupave për vlerësim të konformitetit. Kur kemi emërim të TVK me aktivitet të njëjtë që kryen AMK, në ligjin aktual nuk sqarohet çështja që nëse AMK nëse ka kapacitete a mund të kryej shërbime të njëjta siç kryen edhe TVK-ja e emëruar.

4.Për autorizimin e trupave për shërbime metrologjike nuk ka dispozitë ligjore që e rregullon kohën e shpalljes së ftesës publike. Kjo po krijon një problem për subjektet ekonomike të interesuara dhe njëkohësisht krijon hapësira të mosfunksionimit normal dhe përcaktimit të qartë të kritereve bazë për autorizim

Analiza 4: Në Nenin 36 të Ligjit nr. 06/L -037 për Metrologji që është në fuqi, rregullohet çështja e autorizimit të subjektit juridik për riparimin dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim, por nuk e përcakton se kush e krijon komisionin për vlerësimin e kushteve për autorizim dhe kohën se kur duhet të autorizohen.

5. Nuk janë të përcaktuara masat ndëshkuese për operatorët ekonomik të cilët operojnë pa qenë të autorizuar nga AMK për shërbime metrologjike duke i përfshirë edhe operatorët ekonomik që janë në proces të autorizimit

Analiza 5: Neni 36 i Ligjit nr. 06/L -037 për Metrologji që është në fuqi, rregullon çështjen e autorizimit të subjektit juridik për riparimin dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim por nuk e ka asnjë dispozitë ligjore që rregullon masat ndëshkimore për operatorët ekonomik të cilët ofrojnë shërbime metrologjike pa autorizim nga AMK

6. Nuk ka dispozitë ligjore që obligon verifikimin e saktësisë së instrumenteve matëse medicinale

Analiza 6: Në asnjë dispozitë ligjore të ligjit aktual për metrologji nuk është e përcaktuar forma e kalibrimit/verifikimit të instrumenteve matëse medicinale. Asnjëherë deri më tani pajisjet matëse medicinale që gjinden në përdorim në shëndetësinë kosovare nuk është e verifikuar saktësia e tyre zyrtarisht. Kjo na tregon se rezultatet të cilat i marrim nga institucionet shëndetësore mund të jenë të pa sakta dhe mund të kushtojnë me jetë.

7.Etalonët e matjeve dhe materialet referente në metrologjinë ligjore duhet të rregullohet me qëllim të eliminimit të parregullsive dhe përzierjes së kompetencave.

Analiza 7: Në neni 28 të Ligjit nr. 06/L-037 për Metrologji që është në fuqi është e rregulluar kjo çështje por krijohen paqartësi dhe përzierje të kompetencave në mes të menaxhmentit dhe specialistëve të laboratorëve.

8. Inspektimi, mbikëqyrja - nuk është e rregulluar si duhet, nuk janë të ndara detyrat e inspektimit dhe ato të mbikëqyrjes profesionale metrologjike

Analiza 8: Në Nenin 42 të Ligjit nr. 06/L -037 për Metrologji që është në fuqi janë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektimit dhe mbikëqyrjes metrologjike. Me Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Tregut, disa prej kompetencave të inspektimit metrologjik janë në proces të bartjes te ky institucion. Ka nevojë gjithashtu të përcaktohet

kompetenca për shqiptimin e gjobave nga Inspektorati, Por edhe të rishikohen sanksionet për të siguruar përputhje me Ligjin për Kundërvajtje.

9. Nevoja për digjitalizimin e shërbimeve metrologjike

Analiza 9: Përderisa AMK ofron shërbime metrologjike dhe njëkohësisht autorizon trupa për përgatitjen e instrumenteve matëse për verifikim dhe përmes Ministrisë emëron trupa për vlerësim të konformitetit, lehtëson operatorët ekonomik që të marrin shërbime digjitale si forma kërkesa online për verifikime dhe kalibrime, aplikimi online për autorizimin e trupave, emërimin e TVK-ve për fushat specifike të metrologjisë ligjore, miratimin e tipeve të instrumenteve matëse.

Figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuar. Gjithashtu tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ato janë të prekura. Kapitulli 5 jep informacionin se si janë konsultuar këto palë të interesuara.

10. Nevoja për përafrimin e mëtejshëm me acquis të BE-së dhe praktikat e miratuar ndërkombëtare

Analiza 10: Raporti i Komisionit Evropian për vendin 2023 thekson se Agjencia e Metrologjisë së Kosovës ndihmon në sigurimin e harmonizimit të mëtejshëm me acquis të BE-së dhe në zbatimin dhe zhvillimin e sistemeve dhe standardeve të menaxhimit të cilësisë për laboratorët e kalibrimit. Në përgjithësi, Ligji në fuqi ka nevojë të përafrohet tutje me aktet përkatëse të *acquis* të BE-së.

Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet dhe/ose efekti (efektet) me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	Mangësitë ligjore	Puna e AMK-së vështirësohet nga mangësitë e elaboruara më lartë.
Inspektorati i Tregut dhe i Metrologjisë	Mos efikasiteti i procesit të inspektoreve metrologjike dhe përzierje e kompetencave me mbikëqyrjen profesionale metrologjike	Inspektimi/Mbikëqyrja metrologjike nuk bëhet mjaftueshëm për të siguruar zbatimin e ligjit për shkak të përzierjeve të kompetencave
Trupat për vlerësim të konformitetit për fusha specifike për metrologji ligjore	Mangësitë ligjore dhe mos efikasiteti i procesit të mbikëqyrjes së TVK-ve.	TVK-të hasin në vështirësi gjatë ndërveprimit të tyre me AMK. Disa prej tyre pësojnë nga konkurrenca jo e drejtë dhe nga

	Dëmtimi i subjekteve dhe konkurrencës.	inspektimi/mbikëqyrja jo profesionale e metrologjisë.
Trupat e autorizuar për përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim	Efikasiteti i procesit të mbikëqyrjes së trupave të autorizuar. Dëmtimi i subjekteve dhe konkurrencës.	Trupat hasin në vështirësi gjatë ndërveprimit të tyre me AMK. Disa prej tyre pësojnë nga konkurrenca jo e drejtë dhe nga inspektimi/mbikëqyrja jo profesionale e metrologjisë
Doganat e Kosovës	Efikasiteti i procesit të mbrojtjes së konsumatorëve nga pajisje matëse jo profesionale	Në mbrojtje të tregut dhe të konsumatorëve, nga pajisje matëse me origjinë të dyshimtë dhe pa dëshmi të saktësisë së pajisjes.
Drejtoria e Akreditimit të Kosovës	Akreditimi i laboratorëve testuese/ kalibruese dhe verifikuese	Ofrimi i ekspertëve teknik në procesin e akreditimit
Agjencia e Standardizimit të Kosovës	Kërkesat për standarde	Pjesëmarrje në komitetet teknike
Konsumatorët	Dëmtimi i konsumatorit.	Konsumatorët dëmtohen nga cilësia jo e duhur e shërbimeve metrologjike.

1.1 Analiza e Transpozimit të Acquis së BE-së

Gjatë procesit të hartimit të Ligjit në fuqi për Metrologjinë (2018) janë përgatitur tabelat e përputhshmërisë me aktet në vijim të *acquis*:

- Direktiva 2014/31/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 për harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënien në dispozicion në treg të instrumenteve peshore jo automatikë;
- Direktiva 2014/32/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 shkurt 2014 për harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënien në dispozicion në treg të instrumenteve matëse;
- Direktiva e Këshillit e datës 20 janar 1976 mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me përbërjen sipas peshës ose vëllimit të disa produkteve të parapaketuara (76/211/EEC);
- Direktiva 2007/45/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 5 shtator 2007 që përcakton rregullat për sasitë nominale për produktet e parapaketuara;
- Direktiva e Këshillit e datës 19 dhjetor 1974 mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me shishet e përdorura si enë matëse (75/107/EEC).

Në përgjithësi, niveli i përafrimit të Ligjit vendor me Direktivat e lartpërmendura është ende në fazën fillestare, pra pjesërisht në përputhje dhe marr parasysh dinamikën e procesit integruar të Kosovës në BE, ky përfarim duhet të rritet tutje dhe veçanërisht gjatë përgatitjes së çfarëdo ndryshimi ligjor që mund të planifikohet.

1.1.1 Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

Sa i përket lëvizjes së lirë të mallrave, dispozitat e MSA-së kërkojnë që Republika e Kosovës të zbatojë rregullat e tregtisë së lirë me BE-në dhe në përputhje me këtë të zbatojë Marrëveshjen në përputhje me GATT 1994 dhe dispozitat e përfshira përkatëse të Marrëveshjes së OBT-së.

Kosova obligohet të marrë masat e nevojshme për të arritur gradualisht konformitetin me legjislacionin horizontal dhe sektorial të BE-së për sigurinë e produkteve dhe të sjellë infrastrukturë cilësore, si standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit në përputhje me standardet evropiane.

Kosova ka zhvilluar Programin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) si një dokument kryesor strategjik kombëtar për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha reformave të nevojshme për zbatimin e MSA-së dhe fazat e ardhshme të anëtarësimit në BE.

Në PKIE 2024 - 2028, përkatësisht në bllokun tre: “Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me acquis së BE-së në kapitullin 1 – Lëvizja e lirë e mallrave”, AMK ka listuar një numër masash afatshkurtër dhe afatmesme të cilat duhet të realizohen në periudhën e paraparë.

Kapitulli 2: Objektivat

Qëllimi kryesor i politikës së propozuar është përmirësimi i kornizës ligjore në fushën e metrologjisë, me qëllim që të ruajë, të zhvillojë dhe të përdorë etalonët kombëtarë të njëjësive matëse; të mbrojë konsumatorët nëpërmjet organizimit të kontrollit të instrumenteve matëse në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare, mbrojtjen e shëndetit, mjedisit dhe sigurisë teknike, si dhe kontrollin sasior të parapaketimeve.

Siç u cek edhe më lartë, me përmirësimin e kornizës ligjore synohet të arrihet përputhshmëri më e lartë me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian. Kjo politikë kontribuon në përmbushjen e prioritetëve të reformave ekonomike dhe institucionale që burojnë nga dokumentet strategjike, përkatësisht: Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, Strategjia për zhvillim industrial dhe mbështetje të Biznesit 2030, Programin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024 - 2028.

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
---------------------	---

<i>Strategjik: Ndërtimi i një mjedisi biznesi të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues duke zbatuar standardet e përbashkëta metrologjike.</i>	SZHIMB 2030, PKZH 2024 – 2026,
<i>Specifik: Hartimi i legjislacionit primarë dhe sekondarë duke përfshirë harmonizimin e legjislacionin përkatës në fushën e metrologjisë</i>	Sipas këtij Koncept Dokumenti
<i>Specifik: Rritja e cilësisë dhe besueshmërisë të shërbimeve metrologjike në sigurinë, cilësinë dhe saktësinë e produkteve.</i>	SZHIMB 2030, PKZH 2024 – 2026,
<i>Specifik: Avancimi i shërbimeve në fushën e Metrologjisë dhe Ngritja e kapaciteteve njerëzore në numër dhe në aspektin profesional</i>	Koncept dokumenti
<i>Specifik: Thjeshtëzimi dhe digjitalizimi i mënyrës së aplikimit për ofrimin e shërbimeve metrologjike</i>	Koncept dokumenti, Programi për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative.
<i>Specifik: Zhvillimi i fushatës vetë dijesuese dhe informuese</i>	Sipas këtij Koncept Dokumenti

Kapitulli 3: Opsionet

Nga grupi punues janë trajtuar gjithsej tri opsione për adresimin e problemit të identifikuar më lartë dhe arritjen e objektivave. Këto opsione janë: 1) opsioni asnjë ndryshim; 2) opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore; 3) opsioni që parasheh ndryshime ligjore.

Krahasimi me vendet tjera

Grupi punues gjatë përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti, ka marr parasysh përvojat e Kroacisë, Sllovenisë, Shqiperisë, për të krahasuar çështje të identifikuara në Kapitullin 1 dhe që janë konsideruar të rëndësishme për të i krahasuar.

Çështja e trajtuar	Shqipëri	Sllovenia	Kroacia
